



Republika e Kosovës
Republika Kosovon - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 11

Prishtinë, më 23.02.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvie Halimi, Danush Ademi, Armend Zemaj, Doruntina Maloku, Agim Ademaj, Agim Aliu, Nezir Çoçaj dhe Melihate Tërmmkolli.

Munguan: Fatmir Limaj dhe Milena Miliqeviq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Petrit Hysaj OSBE, Valdet Hajdini – IKD, Driton Selmanaj – KDI, Lekë Batalli – GLPS, Fitore Berisha – ZPRK, Florina Merovci – ZPRK dhe Blerta Bejtullahu – EUSR/EU office.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Visar Krasniqi dhe Hana Bajraktari.

Mbledhjen e kryesoi: Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 20 dhe 23.01.2015;
3. Formimi i Nënkomisionit për Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit;
4. Formimi i grupit punues për mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit,
5. Nisma e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 20 dhe 23.01.2015

***Kryetarja** konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 20 dhe 23.01.2015, pa vërejtje.*

3. Formimi i Nënkomisionit për Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit

Kryetarja – Vazhdoi me pikën e tretë të rendit të ditës, ku u diskutua për formimin e nënkomisionit, pasi disa herë me radhë është diskutuar në mbledhjet e Komisionit për formimin e nënkomisionit, edhe pse nga ana ime është propozuar të jetë vetëm grup punues që do të merret me Rregulloren e Kuvendit. Mirëpo ka dominuar propozimi për formimin e nënkomisionit. Arsyeja pse kisha propozuar të jetë grup punues edhe për faktin që të mos bëhen shpenzime buxhetore, mirëpo anëtarët e Komisionit kanë menduar se është më mirë të formohet nënkomisioni. Ajo ju referua nenit 70.4 të rregullores, ku kërkohet nga grupet parlamentare t'i emërojnë anëtarët për nënkomision. Lidhur me këtë pikë kryetarja hapi debatin për anëtarët e Komisionit.

Armend Zemaj – Ne kemi vendosur lidhur me formimin e nënkomisionit, pra ne kemi një praktikë nga Rregullorja e punës së Kuvendit. Ju e cekët shumë mirë, pra neve na mbetet vetëm t'i emërojmë anëtarët e nënkomisionit. Ai gjithashtu tha se është shumë e rëndësishme, që kemi pasur një punë të veçantë lidhur me Rregulloren e punës së Kuvendit, ku i gjithë debati është zhvilluar gjashtë muaj rreth punës së Kuvendit. Gjithashtu theksoi se Komisioni Evropian është duke punuar që një kohë me Ligjin për Kuvendin dhe ne, si nënkomision, të vazhdojmë atë punë dhe të shohim se si do të procedojmë. Unë besoj se kolegët e kanë marrë këtë projektligj dhe mendoj se duhet menjëherë të fillojmë të punojmë, sepse edhe ashtu janë procedurat që çdo legjislaturë duhet ta ketë Rregulloren e punës, nga praktikatat e mëhershme. Ne kemi punuar me atë Rregullore të Punës prej Legjislaturës së tretë. Unë mendoj se duhet t'i propozojmë anëtarët dhe të formojmë nënkomisionin.

Kryetarja – Edhe njëherë e lexoi pikën nga Rregullorja e punës së Kuvendit, ku grupet parlamentare propozojnë anëtarët për nënkomision. Mirëpo mund ta propozojë edhe ndonjë anëtar që nuk është anëtar i Komisionit. Prandaj unë këtu kam dilemë, për ndryshe nuk kam ndonjë problem tjetër lidhur me propozimin e anëtarëve. Pra duhet të jemi në pajtim me rregulloren e punës së Kuvendit. Ne mund të kërkojmë nga grupet parlamentare të na i sjellin propozimet për anëtarë të nënkomisionit.

Armend Zemaj – Tha se ne jemi në grupet parlamentare. Pra ne, si anëtarë të këtij Komisioni përfaqësojmë Grupet Parlamentare dhe mund t'i propozojmë anëtarët për formimin e nënkomisionit.

Selvije Halimi – Tha se vetë grupet parlamentare i kanë dedikuar njerëzit që mendojnë se profesionalisht dhe mund të kontribuojnë për këtë Komision. Mirëpo ne edhe mund t'i kërkojmë grupeve parlamentare se a pajtohen me propozime që dikush nga ne të jetë në këtë nënkomision, pse jo, mund të kërkojmë këto propozime. Gjithashtu theksoi se kjo rregullore duhet të shkojë konform Ligjit për Kuvendin dhe jo të jenë në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Kryetarja – Theksoi se pajtohet me anëtarët e Komisionit për mënyrën e zgjedhjes ose propozimeve, mirëpo vetëm të mos ekzistojë dilema se nuk ju kemi në përmbajtje të Rregullores së punës së Kuvendit. Gjithashtu mendoj se propozimi më i mirë kishte me qenë deputeti Armend Zemaj ta kryesojë pasi që ka përvojë të gjatë në përpilimin e Rregullores së punës së Kuvendit nga mandati i kaluar.

Nezir Çoçaj – Theksoi se nëse Grupi Parlamentar nuk i sjell emrat me shkrim atëherë kishte me qenë mirë që ne t'i vendosim emrat sot lidhur me anëtarët e nënkomisionit dhe t'i procedojmë në Kryesinë e Kuvendit që të mos humbim kohë.

Armend Zemaj – Theksoi se nga ana ime është gjithçka në rregull, pra ulemi e vendosim, që të mos humbim kohë, pra edhe anëtarët që nuk janë në këtë nënkomision prapë kanë me qenë të mbikëqyrë lidhur me çështjet që punohet në këtë nënkomision. Pra të gjitha grupet politike janë në dijeni si pengesë e mosfunksionimit të shumë çështjeve është edhe mos ndryshimi i Rregullores së Punës së Kuvendit, jo pse kjo Rregullore nuk është në rregull, mirëpo në Kushtetutë thuhet që çdo legjislaturë duhet të punojë me Rregulloren e punës së vet, kjo është praktikë në gjitha vendet e botës demokratike.

Kryetarja – Ripërsëriti qëndrimin se kjo rregullore duhet të ketë ndryshime, dhe të gjithë deputetët t'i adresojnë mendimet e tyre lidhur me Rregulloren me të cilën do të punojnë.

Melihate Termkolli – Propozoi që të ju drejtohem grupëve parlamentare në mënyrë institucionale, pra nuk mendojë se humbim kohë, dhe gjithashtu sado që punojmë me Rregulloren, nuk ka ndonjë efekt deri sa nuk e kemi Ligjin për Kuvendin, që në të ardhmen të mos kemi mospërputhshmëri.

Pas diskutimeve, kryetarja Konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

P e r f u n d i m

I. Kërkohet nga Grupet parlamentare që të emërojnë anëtarët e Nënkomisionit për Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit në pajtim me nenin 70.4 të rregullores, si vijon:

- | | |
|-----------------------|-------------------------|
| 1. G/P - PDK | 1 (një) anëtar, |
| 2. G/P - LDK | 1 (një) anëtar, |
| 3. G/P - VV | 1 (një) anëtar, |
| 4. G/P - 6+ | 1 (një) anëtar, |
| 5. G/P - AAK | 1 (një) anëtar, |
| 6. G/P – LS | 1 (një) anëtar, |
| 7. G/P - NISMA | 1 (një) anëtar. |

II. Komisioni kërkon që emrat e propozuar të dërgohen më së largu deri më 25.2.2015.

4. Formimi i grupit punues për mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetarja – Tha se meqë ende nuk kemi vendim të Kuvendit me të cilin anëtari nga grupi parlamentar i AAK-së e zëvendëson deputeten Melihate Termkolli atëherë le të mbetet që emri i propozuar nga AAK-ja të jetë kryesues i grupit punues, ashtu siç është diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetarja Konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori:

V e n d i m

I. *Formohet grupi punues për mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit me këtë përbërje:*

- GP AAK - kryesues,
- Albulena Haxhiu - anëtare,
- Nezir Çoçaj – anëtar,
- Doruntinë Maloku – anëtare, dhe
- Agim Ademaj – anëtar.

II. *Në momentin e zëvendësimit të anëtarit nga grupi parlamentar i AAK-së, i njëjti do të marrë edhe obligimet e kryesimit të grupit punues.*

5. Nisma e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Kryetarja – Tha se kemi pranuar shkresën nga Avokati i Popullit ku rekomandohet që të ndryshohet Ligji për Gjykatën Kushtetuese, me theks të veçantë afatin kohor, kur Avokati i Popullit i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për të kontestuar aktet ligjore. Ky afat sipas ligjit në fuqi është gjashtë muaj, dhe propozimi është që ky afat kohor të mos jetë i kufizuar, pra të hiqet kufizimi kohor. Kanë marrë shembuj të vendeve të ndryshme se si e kanë të rregulluar këtë çështje, veçmas ato që kanë sistem të ngjashëm juridik. Ajo propozoi që në mbledhjen e radhës së Komisionit ta ftojë përfaqësuesin e Avokatit të Popullit dhe një përfaqësues të Gjykatës Kushtetuese dhe deputetët t'i prezantojnë shqetësimet lidhur me këtë çështje dhe të shohim se si do të procedojmë.

Komisioni vendosi që në takimin e radhës të ftohet përfaqësuesi i Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Gjykatës Kushtetuese për të diskutuar për këtë çështje.

6. Të ndryshme

Komision diskutoi lidhur me nevojën për hulumtime legislative pasi që në muajin mars 2015, do të procedohen nga Qeveria katër projektligje që janë shumë të rëndësishme për këtë Komision dhe atë: Projektligji për Kundërvajtjet, Projektligji për Avokatin e Popullit, Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Komisioni vendosi që të kërkojë nga Drejtoria për hulumtime, bibliotekë dhe arkiv, e Kuvendit, që të bëjë hulumtime për projektligjet e theksuara pasi që ka një gatishmëri edhe nga USAID-i dhe KDI për ta përkrahur Komisionin përmes ekspertëve.

Kryetarja – I rikujtoi anëtarëve të Komisionit se janë të ftuar të marrin pjesë në drekë pune me ekspertin sloven Primos Vehar, më **24.02.2015**, në orën: **11:00**, në Hotelin Sirius.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Albulena Haxhiu

